



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-060/01-37529
Datë 14.12.2021

Komuna e Gjakovës përmes grupit punues për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, duke u bazuar në nenin 68 paragrafi 68.3 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 14 të Rregullores (MAPL) numër 01/2017 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, nenin 65 paragrafi 65.3 të Statutit të Komunës së Gjakovës, me datën 14.12.2021, publikon këtë:

NJOFTIM

Grupi punues organizon konsultim publik me qytetaret e Komunës së Gjakovës dhe personat tjerë të interesuar lidhur me Draft Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës.

Të nderuar qytetar të Komunës së Gjakovës, përmes propozimeve dhe sugjerimeve tuaja ju mund të kontribuoni që kjo rregullore në draftin final të saj, të jetë edhe më praktike, edhe më profesionale në mënyrë që të përmbushë kërkesat e përgjithshme.

Kopjen fizike të Draft Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës, mund ta siguronit në zyrat e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në objektin e Komunës së Gjakovës çdo ditë punë prej orës 10:00 deri në ora 14:00, duke filluar nga data 15.12.2021, si dhe në ueb faqen e Komunës së Gjakovës <https://kk.rks-gov.net/gjakove/kuvendi/draft-rregulloret/>.

Konsultimi publik mbahet me datën 16.01.2022 në sallën e Kuvendit të Komunës së Gjakovës (ish ndërtesa e Bankosit), me fillim në ora 10:00.

Vërejtjet apo sugjerimet tuaja mund ti drejtohen komisionit drejtpërdrejtë në konsultim apo me shkrim përmes email-it: kushtrim.brahimaj@rks-gov.net.

Kushtrim Brahimaj

Brahimaj

Kryesues i Grupit Punues

